



AYEN ENERGY TRADING sh.a

Raporti i Audituesit të pavarur dhe

Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

PËRMBAJTJA:

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	1
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E PERFORMANCËS	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	5
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	6 – 23

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtuar: Menaxhimit dhe aksionerëve të Shoqërisë AYEN ENERGY TRADING sh.a

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të shoqërisë **AYEN ENERGY TRADING sh.a**, (më poshtë "Shoqëria") të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar të datës 31 dhjetor 2019, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 dhjetor 2019, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likujdohë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënime shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënime shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.



Teit Gjini
Auditues Ligjor

17 shkurt 2020

Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2019

	Shënime	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018	1 janar 2018
			Riparaqitur	Riparaqitur
AKTIVE				
Aktive afatshkurtra				
Aktive afatgjata materiale	6	9,513,213	7,489,703	4,102,537
Aktiv me të drejtë përdorimi	3,7	10,383,637	-	-
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	27	12,513,900	12,629,400	-
Totali i aktiveve afatgjata		32,410,750	20,119,103	4,102,537
Aktivët afatgjata				
Shpenzime të shtyra	8	27,626,510	28,807,133	23,038,991
Inventari	9	81,004	-	-
Llogari të arkëtueshme tregtare	10	19,106,517	104,306,963	489,264,282
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	11,27	44,236,413	185,997,074	54,794,645
Të tjera llogari të arkëtueshme	12	269,988,305	354,450,185	91,366,381
Tatim fitimi	12	4,784,245	-	-
Mjete monetare	13	3,105,885	59,514,710	60,064,201
Totali i aktiveve afatshkurtra		368,928,879	733,076,065	718,528,500
Totali i aktiveve		401,339,629	753,195,168	722,631,037
Kapitali				
Kapitali i nënshkruar		100,000,000	100,000,000	100,000,000
Kapital i papaguar		-	(7,103,900)	(34,111,100)
Fitime të mbartura		69,815,868	(5,658,472)	(40,982,035)
Fitimi i ushtrimit		27,140,028	75,474,340	35,323,563
Totali i kapitalit	14	196,955,896	162,711,968	60,230,428
DETYRIMET				
Detyrime afatgjata				
Hua		-	-	-
Totali i detyrimeve afatgjata		-	-	-
Detyrime afatshkurtra				
Detyrime per qirate	15	10,864,332	-	-
Llogari të pagueshme tregtare	16	6,085,730	100,693,563	65,687,725
Parapagime të marra	17	-	47,680,716	-
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	27	182,296,666	427,397,372	593,944,651
Detyrime tatimore	18	1,346,517	1,124,152	991,010
Tatim fitimi	18	-	11,367,550	1,065,926
Të tjera detyrime	19	3,790,488	2,219,847	711,297
Totali i detyrimeve afatshkurtra		204,383,733	590,483,200	662,400,609
Totali i detyrimeve		204,383,733	590,483,200	662,400,609
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		401,339,629	753,195,168	722,631,037

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 23, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



Pasqyra e Fitim/ humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

Shënime	Për vitin e mbyllur	Për vitin e mbyllur	
	më 31 dhjetor 2019	më 31 dhjetor 2018	
		Riparaqitur	
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	20	2,243,278,751	3,871,027,736
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	21	27,760,436	6,745,904
Totali i të ardhurave		2,271,039,187	3,877,773,640
Lënda e parë, material te konsumueshme	22	(2,145,425,766)	(3,736,750,266)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	6,7	(7,509,479)	(1,269,070)
Shpenzime të personelit	23	(53,889,922)	(36,986,032)
Të tjera shpenzime	24	(25,549,686)	(22,469,263)
Totali i shpenzimeve		(2,232,374,853)	(3,797,474,631)
Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme	25	(2,785,711)	-
Shpenzime të tjera financiare	25	(2,764,367)	9,164,672
Fitim /humbja para tatimit		33,114,256	89,463,681
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	26	(5,974,228)	(13,989,341)
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(5,974,228)	(13,989,341)
Shpenzimi aktual i tatimit te shtyre		-	-
Fitimi/humbja e vitit		27,140,028	75,474,340
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin			
Totali I të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		-	-
Totali I të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		27,140,028	75,474,340

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 23, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



AYEN ENERGY TRADING sh.a

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019


	Kapitali i nënshkruar	Kapitali i papaguar	Fitimet e Pashpërndara	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni më 1 janar 2018	100,000,000	-	(40,982,035)	35,323,563	94,341,528
Fitim/ humbja e vitit				75,474,340	75,474,340
Transferimi në rezultatit e mbartur			35,323,563	(35,323,563)	-
Pozicioni më 31 dhjetor 2018	100,000,000	-	(5,658,472)	75,474,340	169,815,868
Pozicioni më 1 janar 2019	100,000,000	(7,103,900)	(5,658,472)	75,474,340	162,711,968
Fitim/ humbja e vitit				27,140,028	27,140,028
Transferimi në rezultatit e mbartur			75,474,340	(75,474,340)	-
Transaksione me pronarët e kompanisë		7,103,900			7,103,900
Pozicioni më 31 dhjetor 2019	100,000,000	-	69,815,868	27,140,028	196,955,896

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 23, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 janë aprovuar nga administratori i Ayen Energy Trading sh.a dhe janë firmosur si më poshtë



Fahrettin Amir Arman
Administrator


Aida Albayrak
Përgatitëse Pasqyrave

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 Riparaqitur
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim/ humbja e vitit	33,114,256	89,463,681
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:	-	
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	7,509,479	1,269,070
Interes i përlogaritur	579,361	
Diferenca këmbimi jo nga aktivitetet operative	(169,320)	-
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:	-	
Rënie/(rritje) në inventar	(81,004)	-
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	313,594,668	(15,097,056)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme dhe të tjera	(350,853,724)	(73,425,959)
Rritje/(rënie) në parapagime	(47,680,716)	-
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	1,570,641	1,508,550
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	(42,416,359)	3,718,286
	-	
Tati fitimi i paguar	(11,634,031)	(13,989,341)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Hua të dhëna	-	(12,629,400)
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(4,115,439)	(4,656,236)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(4,115,439)	(17,285,636)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Arkëtime nga emetimi i kapitalit aksionar	7,103,900	27,007,200
Ripagime nga huatë	(5,346,896)	
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	1,757,004	27,007,200
Ndryshimi neto i mjeteve monetare	(56,408,825)	(549,491)
Mjetet monetare në fillim të periudhës	59,514,710	60,064,201
Mjetet monetare në fund të periudhës	13 3,105,885	59,514,710

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 23, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



1. Informacion i përgjithshëm

Ayen Energy Trading sh.a, është një shoqëri e regjistruar më 25 shtator 2013 si shoqëri aksionare në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit në përputhje me ligjin 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Shoqëria ka nipt L32130008F. Selia e shoqërisë është Rruga "Papa Gjon Pali i II-të", ABA Business Center, Kati 6, Njësia Bashkiake Nr.2, Tiranë, Shqipëri.

Kapitali i shoqërisë përbëhet nga 1000 aksione me vlerë nominale 100,000 LEK për një vlerë totale 100,000,000 LEK. Aksioneri i vetëm i shoqërisë është Ayen Electric Ticaret Anonim Sirketi. Administrator i shoqërisë është Z. Fahrettin Amir Arman.

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është sigurimi, transmetimi, shpërndarja, importimi, eksportimi dhe tregtimi me shumicë ose pakicë brenda dhe jashtë vendit të energjisë elektrike.

Në vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019 shoqëria ka 45 punonjës (2018: 42). Numri mesatar I punonjesve te kompanise per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019 ishte 43.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

2.2. Aplikimi për herë të parë i SNRF

Këto pasqyra financiare, për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019, janë përgatitur nga Kompania për herë të parë në përputhje me SNRF. Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018, Kompania ka përgatitur pasqyrat financiare në përputhje me parimet e pranuar përgjithësisht të kontabilitetit lokal (Standardet Kombëtare të Kontabilitetit).

Kompania ka përgatitur pasqyrat financiare në përputhje me SNRF për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019, së bashku me të dhënat krahasuese për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018, siç përshkruhet në përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit. Zbatimi i SNRF ka rezultuar në riklasifikimin e pasqyrave financiare si më poshtë për fillimin dhe përfundimin e periudhës krahasuese:

- a) Riklasifikimi i kapitalit të papaguar me vlerë 7,103,900 LEK (01.01.2018: 34,111,100 LEK) nga "Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura" në "Kapital i papaguar"
- b) Detyrimi i tatim fitimit është paraqitur me vehte në pasqyrën e pozicionit duke riklasifikuar vlerën 11,367,550 LEK (01.01.2018: 1,065,926 LEK) nga "Detyrim tatimor" në "Tatim fitim i pagueshëm"
- c) Riklasifikimi i diferencave të këmbimit me vlerë 13,860,922 LEK nga "Të ardhura të tjera" në "Shpenzime të tjera financiare"

2.3. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.4. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.5. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

